

Thirrja nga data 04.12.2024 deri në datën 10.12.2024

**TERMAT E REFERENCESPËR
EKSPERT/E PËR HARTIMIN DHE ZHVILLIMIN E MODULIT TË PROKURIMIT DHE
DOKUMENTEVE MONITORUESE PËR OJQ”NEVO KONCEPTI”**

| | |
|-------------------|---|
| Organizata | OJQ “NEVO KONCEPTI” |
| Objektiva | Hartimi i manualit të prokurimit për OJQ”Nevo Koncepti” |

OJQ “Nevo Koncepti” është organizatë joqeveritare e themeluar më 26 Nëntor 2014. Në themelimin e OJQ “Nevo Koncepti” kanë marrë pjesë intelektualë të komunitetit Romë të cilët përshumë vite janë angazhuar në forma të ndryshme dhe kanë kontribuar në fuqizimin dhe avancimin e pozitës së komunitetit Rom në pjesë të ndryshme të Kosovës sikurse në Prizren, Gjakovë, Ferizaj, Pejë, Rahovec, Fushë Kosovë, Suharekë etj.”

OJQ “Nevo Koncepti” bashkëpunon me fëmijë, të rinjë dhe familje të komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptian, me institucionet publike qendrore dhe lokale, organizata të shumta vendore dhe ndërkombëtare, media dhe palë tjera me interes.

Aktualisht OJQ “Nevo Koncepti” është duke zbatuar 5 projekte në fusha të ndryshme të cilat synimthelohor kanë fuqizimin dhe përmirësimin e pozitës së komunitetit Romë, Ashkali dhe Egjiptian.

1. INFORMATA TË PËRGJITHSHMË RRETH PROJEKTIT

OJQ Nevo Koncepti nga tetori 2023, ka filluar të zbatojë projektin “Fuqizimi i komuniteteve të cënueshme të Kosovës përmes qasjes më të mirë dhe të barabartë në tregun e punës” në Komunën e Prizrenit, Gjakovës dhe Fushë Kosovës.

“Fuqizimi i komuniteteve të cënueshme të Kosovës përmes qasjes më të mirë dhe të barabartë në tregun e punës” është projekt tre vjeçarë i cili implementohet nga OJQ “Nevo Koncepti” në partneritet me Save the Children në Kosovë, financuar nga Agjencia Austriake për Zhvillim me fondet e Bashkëpunimit Austriak për Zhvillim dhe ka si qëllim kryesor fuqizimin e vajzave dhe djemve nga komunitetet romë, ashkali dhe egjiptianë duke u ofruar atyre njohuritë, aftësitë dhe mundësitë e nevojshme për një tranzicion të suksesshëm në moshën madhore dhe punë dinjitoze dhe të qëndrueshme.

2. OBJEKTIVA

Nevo Koncepti kërkon të angazhojë një (1) Ekspert/e për hartimin e manualit të prokurimit bazuar në kërkesat dhe specifikat e NVK-s.

Në kuadër të këtij aktiviteti, do të zhvillohet një punëtori dy ditore me stafin e NVK-së, së bashku me ekspertin për hartimin e manualit të prokurimit.

Qëllimi kryesor i kësaj punëtorie është mbledhja e kërkesave specifike nga stafi i OJQ "Nevo Koncepti", të cilat do të shërbejnë si bazë për hartimin e manualit të prokurimit. Dokumenti i hartuar do të përdoret për zhvillimin e proceseve të prokurimit dhe për rritjen e transparencës në këtë fushë në të ardhmen.

3. KUSHTET QË DUHET TË PLOTSOHEN PËR KËTË ANGAZHIM

Aplikuesi duhet të posedojë përvojë në hartimin e rregulloreve dhe manualit të prokurimit me organizata joqeveritare dhe institucione.

Të jetë i njoftuar me procedurat dhe dispozitat ligjore të prokurimit.

Të drejtë aplikimi në këtë thirrje kanë, të gjithë të interesuarit nga komunat të ndryshme të Kosovës.

4. REZULTATET E PRITSHME

- Të bashkëpunoj me stafin e OJQ "Nevo Konceptit" për mbledhjen e informacioneve dhe kërkesave specifike të OJQ-s.
- Përgaditja e hartimit të manualit të prokurimit në bazë të dispozitave ligjore duke i modifikuar dhe adresuar ato bazuar në kërkesat e OJQ "Nevo Konceptit"
- Dokumeenti i hartimit të manualit të prokurimit duhet të jetë i finalizuar dhe i dorëzuar deri më 18 Dhjetor 2024.

5. AFATI KOHORË I ANGAZHIMIT

Angazhimi i Ekspertit do të fillojë sipas datës së cekura më poshtë:

- 12-18 Dhjetor 2024
-
-

Eksperti do të ketë gjithësej shtatë (7) ditë angazhimi për hartimin e modulit të prokurimit dhe dokumentit të monitorimit dhe vlerësimit:

- Dy ditë punëtori sëbashku me stafin e NVK-s.
- Pesë ditë për hartim dhe finalizim të dokumenteve të kërkuara.

6. INFORMACIONE PËR PAGESËN

Nevo Koncepti do të paguaj Ekspertin me një tarifë bruto ditore (nga e cila do të ndalen dhe paguhen tatimet në të hyrat dhe kontributi përsional, bazuar në ligjin e Kosovës).

Nevo Koncepti do të kryejë pagesën përmes transferit bankar në llogarinë bankare pas përfundimit dhe miratimit të detyrës dhe dorëzimit të dokumenteve mbi angazhimin

7. PROCEDURAT E APLIKIMIT

Të gjithë të interesuarit duhet t'i dërgojnë këto dokumente:

- a) CV.
- b) Referencë nga përvojat e më hershme për hartimin e modulit të prokurimit.
- c) Oferta Financiare bruto për ditë të angazhimit

Aplikimi duhet të dërgohet **jo më larg se data 10.12.2024** në m.elshani@nevokoncepti.org / elshanimuhamed@gmail.com duke e kopjuar (cc) në email o.osmani@nevokonepti.org